

VENDIM
Nr.463, datë 16.6.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, shkronja “c”, 20, shkronjat “ç”, “ë” e “g”, dhe 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe të neneve 76-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I “Kohëzgjatja e punës” bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t’i kërkohej të kryejë orë shtesë.

Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00-6:00.

Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari operacionale, orët shtesë në punë, si rregull, i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00-6:00.

Titullari i institucionit detyrohet t’ia japë kërkuarit këtë pushim, brenda 2 (dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë.

Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale. Çdo orë shtesë tej orarit zyrtar, në ditë të zakonshme paguhet mbi pagën orare edhe me 25 për qind shtesë të kësaj page, ndërsa orët shtesë gjatë ditëve të pushimit apo ditëve të festave, si dhe çdo orë shtesë e kryer nga ora 22:00-6:00 paguhet mbi pagën orare edhe me 50 për qind shtesë të kësaj page.

Rregullat mbi procedurën e kryerjes së pagesës së orëve shtesë përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, mund të kryejë veprimtari mësimdhënieje pas miratimit nga titullari i institucionit, por jo më shumë se 4 (katër) orë në javë, të cilat kompensohen në orë pune, brenda javës, pas orarit zyrtar të punës. Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që angazhohet në mësimdhënieje, detyrohet të depozitojë pranë sektorit të burimeve njerëzore kopjen e kontratës së lidhur me institucionin arsimor.”.

2. Në kreun II “Pushimet” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 2 shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

“Ditët e festave zyrtare nuk duhet të përfshihen në pushimet vjetore të paguara. Nëse nëpunësit të administratës publike dita e festës i bie në periudhën e pushimeve vjetore të paguara, këto të fundit i shtyhen për aq ditë sa ka qenë festa zyrtare.

Rregullat për procedurën e kryerjes së lejes së zakonshme në periudha të ndryshme e të ndara përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pushimet vjetore nuk mund të kompensohen me pagesë, përveç rastit kur është zgjidhur marrëdhënia e punës. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushim vjetor, kundrejt pagesës, do të jetë e pavlefshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha